



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E**  
**ORGANIZUAR**

SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, STATISTIKAVE DHE MARRËDHËNIEVE ME  
PUBLIKUN, MEDIAN DHE ME JASHTË

Tiranë, më datë 04.05.2026

**KOMUNIKIM PËR MEDIAN**

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me trup gjykues monokratik të përbërë nga gjyqtare Saida Dollani, sot më datë 04.05.2026, **shpalli vendimin mbi çështjen penale nr. 120 akti, datë 22.04.2026 regjistrimi**, mbi ankimin e ankuesit I.M: “Ankim kundër vendimit nr. 242, datë 24.03.2026 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me objekt: zëvendësimin e masës së sigurimit personal të arrestit në burg, në një masë tjetër: arrest në shtëpi, garanci pasurore, detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore, ose ndalimi i daljes jashtë shtetit” dhe vendosi:

- Mospranimin e ankimit të paraqitur nga i pandehuri I.M., nëpërmjet mbrojtësit av. Kujtim Cakrani, ndaj disponimit nr. 242, datë 24.03.2026 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
  - Ky vendim t’i njoftohet palëve.
  - Ndaj këtij vendimi mund të bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë.
- Tiranë, më 04.05.2026.

*Kontakt:*

*Enida Demiraj*

*Shef i Sektorit të IT, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë*

*Email: [enida.demiraj@gjykata.gov.al](mailto:enida.demiraj@gjykata.gov.al)*

*Tel: +355 69 72 30 447*